



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 882/12 Prot.

Durrës, më 13.03.2025

VENDIM

Nr. 37, datë 13.03 2025

**"Për pagesën e anëtarëve të komisioneve të ngritura nga secili fakultet për
përzgjedhjen e kandidatëve fitues sipas kritereve të përcaktuara në programet e
ciklit të parë të studimeve për vitin akademik 2024-2025"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin e personelit akademik", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore", Urdhërit të Përbashkët nr. 112, datë 05.07.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2024-2025", të ndryshuar, Urdhërit nr. 278 datë 01.07.2024 të Rektorit "Per kryerjen e pushimeve vjetore 2024 per stafin akademik, Urdhërit nr. 298 datë 12.07.2024 të Rektorit "Për ngritjen e grupit te punës, për monitorimin e procesit te regjistrimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë për vitin akademik 2024-2025", relacionit të administratorit nr.861 prot., datë 12.03.2025 "Përcillet relacioni mbi kostot financiare të pagesës së orëve të punës, të punuara gjatë procesit të përzgjedhjes, monitorimit dhe regjistrimit të studentëve fitues në vitin e parë, për vitin akademik 2024-2025", Bordi i Adminitrimit

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesës së orëve të punës jashtë orarit të anëtarëve të komisioneve të ngritura nga secili fakultet për përzgjedhjen e kandidatëve fitues sipas kritereve të përcaktuara në programin e ciklit të parë të studimeve, për vitin akademik 2024-2025.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet :

- Administratori
- Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDI TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

